

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Situatë jashtëzakonisht e rëndë për sigurinë dhe stabilitetin e Ballkanit", Ish-ambasadori Bimo për vendi min e Gjykatës Speciale: I politizuar, shqiptarët u kthyen në plaçkë tregu
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/situate-jashtezakonisht-e-rende-per-sigurine-dhe-stabilitetin-e-ballk-i401488
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 19:40:26 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 19:41:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	da7ead601e3b19011376539a43698f9d506cc150a7db5df113f1204a758641a7
TEKSTI	65a7db437a3a271c94f56543d4f64f21eff69122d163decf571aebcbbbd848bc
PAMJA	f6723cc1e0fd1143a3584f0f9d878a504bcf2a215ca8489fd7783c8481c21fdb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	43f750412be709c4bbe8fafd75c8fb5328d363f860661bebfdbcc74655be5d71
E MËPARSHMJA	5d410aaa9d3e3017e60bc1773998abdcc529e296f84845f2af576981c6abf3ce
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/43f750412be709c4bbe8fafd75c8fb5328d363f860661bebfdbcc74655be5d71>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

Aktualitet

17 Shtator 2026, 21:41

"Situatë jashtëzakonisht e rëndë për sigurinë dhe stabilitetin e Ballkanit", Ish-ambasadori Bimo për vendimin e Gjykatës Speciale: I politizuar, shqiptarët u kthyen në plaçkë tregu

Shkruar nga Newsbomb



Ish-ambasadori i Shqipërisë në SHBA, Roland Bimo

Ish-ambasadori i Shqipërisë në SHBA, Roland Bimo, e konsideron vendimin e Gjykatës Speciale si një vendim të një gjykate tërësisht të politizuar. Duke iu referuar intervistës së Paul Williams në Zërin e Amerikës, Bimo thotë se shpjegimi pse SHBA u bashkua me europianët për t'i bërë presion Kosovës për të pranuar gjykatën, tregon se çështja shqiptare në rajon është kthyer në plaçkë tregu për fuqitë e mëdha, siç ka qenë në vitin 1913.

Sipas tij, rreziku është edhe më i madh në planin politik dhe të sigurisë. Bimo argumenton se Evropa, për të shlyer njollën e zezë të turpit që është krijuar në territorin e saj nga gjenocidi serb, mundohet të krijojë një ekuivalent moral duke fajësuar shqiptarët. Ai shton se gjykata shkon drejt dënimit sepse janë harxhuar 500-600 milionë euro për të justifikuar një investim jo vetëm financiar, por edhe moral dhe politik të Evropës, duke krijuar një precedent që sipas tij inkurajon Serbinë dhe Republikën Serpska të mendojnë se mund të bëjnë çfarë të duan.

Për këtë arsye, Bimo kërkon veprim urgjent politik, përtej apelimit juridik. Ai përmend propozimin për të shqyrtuar të drejtën kushtetuese të presidentit të Kosovës për falje dhe bën thirrje për lobim në Uashington, duke theksuar se për sa kohë kjo gjykatë ka treuar aë nuk është iuridike. Por tërësisht e ndikuar politikisht. SHBA duhet të shprehë

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Rajoni

"Është krenar që ka luftuar për Kosovën e re", avokatja e Jakup Krasniqit: Asnjë dëshmitar nuk tha se ishte keqtrajtuar nga ai, përkundrazi, folën me shumë vlerësim (E PLOTË)



Ekonomi

Rikonstruksioni i rrugës Kombinat-Ndroq-Plepa, kompania "G.P.G" shpallet fituese e Lotit 3 me ofertë rreth 10 milionë euro

Zbulu më shumë artikuj >

dyshimet e saj ashtu siç ka bërë për Gjykatën Ndërkombëtare Penale, ICC.

"Kemi të bëjmë me një vendim të një gjykate tërësisht të politizuar dhe trajtimi i mëtejshëm i problemit pa dyshim që meriton vëmendjen nga ana juridike, etapat dhe hapat që duhet të ndiqen për apelimin, por në radhë të parë duhet t'i kushtohet vëmendje e duhur politike.

Në këtë mënyrë të menduari më është përforcuar duke ndjekur sot pasdite një intervistë të zotit Paul Williams me Ledia Kostretën në Zërin e Amerikës, ku ai ngre disa probleme, ndër të cilat ka një shprehje që tërheq jashtëzakonisht shumë vëmendjen, ku ai thotë pse amerikanët ishin në favor të evropianëve dhe u bashkuan me evropianë për t'i bërë presion qeverisë së Kosovës për të pranuar gjykatën. Dhe ai thotë se kjo gjë u duhej amerikanëve, po e citoj fjalë për fjalë, në shkëmbim të koncesioneve të tjera të cilat Evropa mund të bënte për çështje më të mëdha, që do të thotë se çështja shqiptare në rajon është kthyer në plaçkë tregu për fuqitë e mëdha, siç ka qenë në vitin 1913, siç ka qenë gjatë gjithë historisë së popullit shqiptar.

Në këto kushte, vëmendje do të duhet juridike, patjetër e domosdoshme, por duhet jashtëzakonisht shumë edhe politike. Dhe përsëri i njëjti person, për të cilin unë kam një respekt të jashtëzakonshëm, jo vetëm për mënyrën se si ka dëshmuar në mbrojtje të katër zyrtarëve të lartë të UÇK-së, por edhe për shërbimet që i ka dhënë Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe rajonit në gjithë karrierën e tij, ai thotë se i sugjeron qeverisë së Kosovës të ndërmarrë urgjentisht hapa për çbërjen e gjykatës dhe brenda mundësive, nëse shihet nga ana kushtetuese, nëse presidenti, presidentja, kushdo që të jetë i Kosovës, ka të drejtën e faljes, pra për të dalë nga ngërçi politik që është krijuar.

Sepse në vlerësimin e tij, dhe përderisa po e citoj, edhe timin, është krijuar një situatë jashtëzakonisht e rëndë për çështjet e sigurisë dhe të stabilitetit të Ballkanit, për të cilat Evropa, për të shlyer njollën e zezë të turpit që është krijuar në territorin e saj nga gjenocidi serb, mundohet të krijojë një ekuivalent moral duke fajësuar shqiptarët, në mënyrë që t'i drejtohet opinionit të vet të brendshëm dhe të thotë se çfarë mund të bëja unë me serbët kur fajin e kishin shqiptarët.

Pra, në narrativën evropiane kjo që ka ndodhur është jashtëzakonisht e rrezikshme dhe për këtë gjë ka paralajmëruar edhe Andrew-i më 5 korrik të këtij viti kur thotë se gradualisht po fryhet një situatë ku, me dashje apo pa dashje, me vullnet apo pa vullnet, gjykata do t'i dënojë këta njerëz sepse janë harxhuar 500-600 milionë euro për të justifikuar një investim, jo vetëm paratë, por edhe një investim moral dhe politik të Evropës, e cila paralajmëron një destabilizim të mëtejshëm të Ballkanit duke inkurajuar serbët e Serbisë me në krye zotërinë që është sot president, por edhe ata që janë në Republikën Srpska, për të thënë se ne mund të bëjmë çfarë të duam dhe në fund të ditës evropianët do të ngrenë një gjykatë e cila do të dënojë viktimat tona, nuk do të na dënojë ne.

Pra, precedenti është jashtëzakonisht i rrezikshëm jo vetëm nga ana juridike, por në radhë të parë nga ana politike. Dhe ajo që sugjerohet është që duhen ndërmarrë hapa të shpejtë, të jashtëzakonshëm politikë. Kush ka mundësi të ndikojë në administratën amerikane përmes lobimeve apo përmes influencave të caktuara? Sepse për sa kohë kjo gjykatë ka treguar që nuk është një gjykatë juridike, por është një gjykatë tërësisht e ndikuar politikisht, atëherë do të duhet që në këtë këndvështrim Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ashtu sikurse kanë treguar që nuk kanë hezituuar asnjëherë të shprehin dyshimet e tyre për paanshmërinë e Gjykatës Ndërkombëtare të Krimeve, ICC-së, ta bëjnë të njëjtën gjë edhe me këtë lloj gjykate.

Por në këndvështrimin e tërësisë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë angazhime kudo në botë, do të duhet që faktori shqiptar, ata që janë atje në Shtetet e Bashkuara të Amerikës apo edhe shtetet shqiptare dhe kush ka mundësi, dhe besoj që ne kemi jashtëzakonisht shumë në dorë për të qenë faktor stabiliteti siç kemi qenë deri tani, por jo që të jemi plaçkë tregu siç po na trajton vendimi i kësaj gjykate." tha Bimo.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Enjte 23:13

"Dokumente nga BIA serbe dhe janë servitur Gjykatës Ndërkombëtare", Karamuço: Kur ne merreshim me gjëra banale, ata bënin strategji si të njollosnin luftën e UÇK-së



Aktualitet

PAMJE DRAMATIKE nga Saranda: I riu qëllohet me thikë teksa qethej, shokët e tij përleshën me agresorin në derën e berberhanes, tavolina e karrige fluturojnë kokës

🕒 E Enjte 22:55



Aktualitet

"Pagat kalojnë vetëm nga dera e ligjit", Ministri Gogu: Askush s'mund t'ia caktojë vetes rrogën

🕒 E Enjte 22:47



🕒 E Enjte 21:09

Tragjedi në Athinë! Të rinjtë nga Fieri aksidentohen me makinë, tre të vdekur dhe dy të plagosur rëndë (FOTO-NGJARJA NË GLYFADA)





Aktualitet

Policia shpall në kërkim vlonjatin David Isaac, 41 vjeçari "merr në qafë" dhe punonjësit e Gjendjes Civile sepse i dhanë EMËR izraelit pa e verifikuar (DETAJE)

E Enjte 20:26



Aktualitet

"U përdoqa nga një grup që më ngjanin me pionerët e Enverit", Iris Luarasi denoncon valën e komenteve kërcënuese pas videos virale

E Enjte 20:26



E Enjte 20:01

I ngatërruan emrin me biznesmenin e arrestuar të pronave, qytetari ankohet në AMA



Aktualitet

Gjyqtarët bënë kallëzim në SPAK për pagat, agjentët e BKH-së zbarkojnë në Kuvend, raportohet për sekuestrim dokumentesh

E Enjte 19:13



Aktualitet

Kërcënohet kryeinspektori Dash Sula, bën denoncim në polici: Pavarësisht presioneve, nuk kam frikë

E Enjte 18:46



Organizatorët përplasen me njëri-tjetrin, gazetarja: Protesta është siç e do Rama! Aktivisti: Kërkove përshkallëzim, ndërkohë vetë nuk vjen se s'e lë punën



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.